



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

BALANCA VJETORE (E REALIZUAR) E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2010

GODIŠNJI ENERGETSKI BALANS (REALIZOVANI)
REPUBLIKE KOSOVA ZA 2010. GODINU

ANNUAL (REALIZED) ENERGY BALANCE OF
REPUBLIC OF KOSOVO FOR THE YEAR 2010

Prishtinë, 2011



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

**BALANCA VJETORE (E REALIZUAR) E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2010**

Prishtinë, 2011

Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Balancave të Energjisë në MZHE. Pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me entitetet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Rregullat për Bilancin e Energjisë, ky dokument nuk do të mund të përgatitej.

Vonesa e finalizimit të këtij dokumenti ka ardhur si pasojë e pritjes së raportit final të Studimit të konsumit të energjisë nga biomasa, Studim ky i kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, i cili është përfunduar 14.11.2011

Përmbajtja

Shkurtesat

Përmbledhje ekzekutive

1. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2010	1
1.1. Burimet primare	1
1.1.1. Thëngjilli	2
1.1.2. Produktet e naftës	3
1.1.3. Biomasa (Dru zjarri)	3
1.1.4. Energjia Elektrike	4
1.1.5. Hidroenergjia	4
1.1.6. Energjia e Erës	4
1.1.7. Energjia Solare	4
1.1.8. Biokarburantet	4
1.2. Konsumi i energjisë	4
1.2.1. Konsumi i thëngjillit	7
1.2.2. Konsumi i produkteve të naftës	8
1.2.3. Konsumi i energjisë elektrike	9
1.2.4. Konsumi i ngrohjes së përfituar	9
1.3. Konsumi në sektorin e industrisë	10
1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë	10
1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë	10
1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë	11
1.3.4. Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë	12
1.3.5. Pjesëmarrja e nën-sektorëve të industrisë në konsumin energjisë	13
1.4. Konsumi në sektorin e amvisërisë	14
1.4.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë	14
1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë	15
1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë	15
1.5. Konsumi në sektorin e shërbimeve	16
1.5.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve	16
1.5.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e shërbimeve	17
1.5.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve	18
1.6. Konsumi në sektorin e transportit	18
1.6.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit	18
1.7. Konsumi në sektorin e bujqësisë	19

1.7.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë	19
1.7.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë	20
1.7.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë	21
1.8. Mbulimi i kërkesës me energji	21
1.8.1. Furnizimi me thëngjill (lignit)	21
1.8.2. Furnizimi me energji elektrike	21
1.8.3. Furnizimi me produkte të naftës	22
1.9. Treguesit e konsumit të energjisë	23
1.10. Ndotja e mjedisit	23
2. Konkluzionet dhe Rekomandimet	25
2.1. Konkluzionet	25
2.2. Rekomandimet	25
SHTOJCAT	27
Shtojca 1. Karakteristikat e sistemit energjetik të Kosovës	28
Shtojca 2. Karakteristikat e burimeve energjetike dhe konvertimi i njësive	29
Shtojca 3. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2010	31

Shkurtesat

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operatori i Sistemit dhe Tregut
KEK sh.a	Korporata Energjetike e Kosovës
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MF	Ministria e Financave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
DK	Doganat e Kosovës
ESOK	Shoqata për Energji Solare e Kosovës
HK	Hekurudhat e Kosovës
SKE	Sekretariati i Komitetit të Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
CRES	Qendra për burime të ripërtëritshme dhe kursimin e energjisë, Athinë-Greqi
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
IEA	Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hidrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor

Përmbledhje ekzekutive

Balanca vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2010 është dokument i aprovuar nga MZHE, respektivisht nga Sekretari i Përgjithshëm me vendim të dt:01.12.2011.

Përgatitja e Balancës vjetore (të realizuar) e Energjisë për vitin 2010 është bërë nga divizioni përgjegjës për balanca të energjisë në kuadër të Departamentit përgjegjës për energji në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës 2010 është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit për Energjinë nr.03/L-184.

Në këtë dokument pasqyrohen rrjedhat e energjisë së të gjitha llojeve dhe burimeve që janë përdorur në Kosovë gjatë vitit 2010.

Të dhënat janë grumbulluar nga entitetet si në vijim:

- Ministria e Financave – të dhënat për BPV;
- Enti i Statistikave të Kosovës - të dhënat demografike dhe sociale;
- KEK sh.a – të dhënat për thëngjillin (prodhimi, furnizimi dhe stoqet), të dhënat për konsumin e energjisë elektrike;
- KOSTT- të dhëna periodike mujore, si dhe vjetore të balancës elektro energjetike;
- “Kosova Thëngjilli” sh.a., të dhënat për tregtimin e thëngjillit të përpunuar, të nxjerrë nga mihjet në Kosovë;
- Doganat e Kosovës - të dhënat për import dhe eksport të të gjitha produkteve të energjisë që hyjnë dhe dalin nga Kosova;
- Ndërmarrjet e Ngrohjeve Qendrore- të dhënat për rrjedhat energjetike në ndërmarrjet e ngrohjes;
- MBPZHR dhe APK- të dhënat për drurin;
- Hekurudhat e Kosovës- të dhënat për konsumin e lëndëve djegëse në Hekurudhat e Kosovës;
- Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës “Adem Jashari”- të dhënat për konsumin e lëndëve djegëse në ANP;
- ESOK - të dhënat për Energjinë solare.

Bashkëpunimi me këto entitete si viteve të tjera, edhe këtë vit ka qenë tepër korrekt dhe institucional dhe për këtë MZHE i falënderon.

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2010 bazohet, gjithashtu në të dhënat e studimit: “Anketimi i konsumit të biomasës për qëllime të energjisë në Komunitetin e Energjisë”, të kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Ky studim ka marrë në konsideratë edhe kualitetin e drurit të përdorur për qëllime energjetike në Kosovë, duke i kategorizuar sipas diametrit dhe lagështisë së drurit. Të dhënat e këtij studimi kanë nxjerrë në pah një dallim jo të vogël për sa i përket sasisë së energjisë së përdorur të drurit në krahasim me studimet e mëparshme. Dallimi nuk është i dukshëm në aspektin vëllimor të drurit të përdorur, por është në aspektin e sasisë së energjisë ku janë marrë parasysh faktorët e lartpërmendur.

Në këtë dokument secili produkt energjetik është trajtuar dhe analizuar në gjithë procesin e përdorimit të tij që nga burimi i furnizimit deri në konsumin final të tij. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar, sistemuar dhe paraqitur sipas formatit të EUROSTAT-it.

1. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për vitin 2010

Dy nga pjesët kryesore të Balancës së realizuar të energjisë janë burimet primare - respektivisht furnizimi me energji dhe konsumi i energjisë apo shpërndarja e konsumit të energjisë sipas sektorëve të ekonomisë. Të dy këto pjesë do të analizohen në vijim.

1.1. Burimet primare

Struktura e energjisë primare të konsumuar në Kosovë në vitin 2010 nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin 2009. Atë e përbëjnë: thëngjilli, produktet e naftës (benzina, diesel, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës - GLN), biomasa, energjia elektrike, hidroenergji, energjia e erës, energjia solare dhe biokarburantet. Energjia elektrike si energji primare trajtohet energjia e importuar dhe e eksportuar.

Siç vërehet nga Tabela 1 dhe Figura 1, sasia bruto e energjisë në dispozicion në vitin 2010 është 2437.51 ktoe, ose një rritje prej 2.74 % krahasuar me vitin 2009.

Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	1408.13	1595.24	1680.86
Produkte naftë	437.16	489.13	466.13
Biomasa	233.12	234.73	236.35
Energjia elektrike	35.47	42.44	40.07
Hidroenergji	6.54	10.29	13.38
Energji solare	0.56	0.58	0.61
Energjia e erës			0.04
Biokarburante	0.20	0.10	0.07
Totali	2121.19	2372.51	2437.51

Siç shihet, kemi një rritje të sasisë në dispozicion të thëngjillit prej 5.37% krahasuar me vitin 2009.




Figura 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion (ktoe)

Të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga druri i zjarrit (biomasës) për vitin 2010 janë të bazuara në rezultatet e studimit të biomasës të realizuar nga kompania CRES e kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të cilat janë rrikalkuluar mbi bazën e të dhënave preliminare demografike nga Regjistrimi i popullsisë REKOS 2011. Mbi bazën e këtyre të dhënave janë bërë rishikimet e të dhënave të konsumit të këtij lloji të burimit të energjisë për vitet 2008 dhe 2009.

Në burimet primare të energjisë në dispozicion, energjia elektrike e importuar dhe eksportuar trajtohet si energji primare, sipas udhëzuesit për statistikat e energjisë të Eurostatit.




Figura 2. Pjesëmarrja e burimeve primare në dispozicion për vitin 2010 (%)

1.1.1. Thëngjilli

Furnizimi dhe përdorimi i thëngjillit në vitin 2010 ka qenë 1680.86 ktoe. Në tabelën 2 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga thëngjilli.

Tabela 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracite	8.10	4.44	20.81
Thëngjill bituminoz dhe tjera	13.91	10.28	7.00
Thëngjill guri për koks	0.01	0.00	0.01
Lignit/Thëngjill i murrmë	1382.28	1580.32	1652.54
Koks dhe gjysmë koks	3.55	-0.05	0.11
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.01	0.01
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.27	0.25	0.37
Totali i thëngjillit	1408.14	1595.24	1680.86




Figura 3. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Nga tabela shihet që prej të gjitha llojeve të thëngjillit, linjiti ka një pjesëmarrje prej 98.32% në totalin e thëngjillit si burime primare në dispozicion, i pasuar nga antraciti me 1.24 % dhe thëngjill bituminoz dhe tjera me 0.42 %. Në prodhimin primar të thëngjillit merr pjesë vetëm linjiti.

1.1.2. Produktet e naftës

Importi i produkteve të naftës për vitin 2010 ka qenë 466.13 ktoe. Në tab. 3 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga produktet e naftës

Tabela 3. Pasqyra e sasisë së produkteve të naftës si burimeve primare në dispozicion (ktoe)

Produktet e naftës	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.01	0.01
Benzinë aviacioni	0.10	0.00	0.05
Benzinë	91.66	96.25	82.56
Kerozinë	0.30	1.24	1.24
Vajra karburantesh/mazuti	82.99	93.24	77.47
Naftë	209.29	246.18	247.04
GLN	27.48	33.72	27.53
Koks nafte	24.84	16.29	29.33
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	1.25
Mbetje nafte	0.20	0.00	0.00
Bitumen	0.30	3.03	-0.35
Totali	437.16	489.95	466.13




Figura 4. Pasqyra e sasisë së produkteve të naftës si burime primare në dispozicion (ktoe)

Nga figura 4. shihet që pjesëmarrja e naftës është më e larta nga të gjitha llojet tjera të produkteve të naftës me një pjesëmarrje prej 53% në totalin e sasisë së produkteve të naftës në dispozicion, e pasuar nga benzina me 17.71%, mazuti 16.62%, koks nafte 6.29% dhe GLN me 5.91%.

1.1.3. Biomasa (Dru zjarri)

Vazhdon të mbetet problematike çështja e sigurimit të të dhënave për sasinë e druve të zjarrit të prera në Republikën e Kosovës. Të dhënat që ka në dispozicion Agjencia Pyjore e Kosovës flasin për një sasi shumë të vogël të druve të prera në Kosovë. Në anën tjetër nevojat e vlerësuara të popullatës për ngrohje janë shumë herë më të larta sesa të dhënat zyrtare me të cilat disponohet. Të dhënat nga importi, po ashtu flasin për një sasi fare të vogël në krahasim me kërkesat.

Nuk ekzistojnë shifra reale sa i përket shkallës së prerjes së druve të zjarrit. Të dhënat e prodhimit (prerjes) janë bazuar në dokumentin e Strategjisë së Pylltarisë për vitin 2010-2020. Analizat janë zhvilluar mbi bazën e shkallës së rritjes vjetore të fondit të pyjeve duke lejuar prerjen e 70% të sasisë së rritjes vjetore dhe duke i shtuar kësaj sasi diferencën në mes të prodhimit dhe konsumit të biomases, të dala nga anketat e realizuara për konsumin

e biomasës.

Sasia e konsumuar e druve të zjarrit vetëm nga ana e amvisërisë ka qenë 5.9 m³ për amvisëri në vitin 2010. Nëse i marrim parasysh të gjithë sektorët e ekonomisë, konsumi i drurit për zjarr gjatë vitit 2010 ka qenë 236.35 ktoe.

Duhet pasur parasysh faktin se vlerësimet janë zhvilluar duke pasur në konsideratë edhe kualitetin e druve të zjarrit sipas vlerës së tyre kalorike (prej 3.5 MJ/m³ deri 7.0 MJ/m³).

Briketet që prodhohen dhe importohen janë në sasi shumë të vogël, ndërsa llojet e tjera të biomasës nuk përdoren në Kosovë.

1.1.4. Energjia Elektrike

Energjia elektrike, si energji primare, trajtohet si energjia e importuar dhe e eksportuar, e cila në vitin 2010 ka qenë 40.07 ktoe (import-eksport).

1.1.5. Hidroenergjia

Të dhënat për hidroenergji janë siguruar nga KEK-u dhe KOSTT-i, të bazuara në sasinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet: Ujmani, Lumbardhi, Radavci dhe Dikanci.

Prodhimi vjetor i hidroenergjisë në vitin 2009 ka qenë 10.29 ktoe, ndërsa në vitin 2010 ka qenë 13.38 ktoe, që është një rritje prej 30.03% krahasuar me vitin 2009.

1.1.6. Energjia e Erës

Që nga viti 2010 kemi edhe megavatët e parë të prodhimit të energjisë elektrike nga era. Sasia e kësaj energjie është 400 MWh energji elektrike.

1.1.7. Energjia Solare

Të dhënat për energjinë solare janë të vlerësuara në bazë të të dhënave të vitit 2008 nga dokumenti i bilancit të energjisë dhe në bazë të studimeve relevante.

1.1.8. Biokarburantet

Biokarburantet bëjnë pjesë në burimet e ripërtëritshme të energjisë, ku sasia e energjisë nga biokarburantet vjen kryesisht nga importi, i cili për vitin 2010 ka qenë 0.07 ktoe.

1.2. Konsumi i energjisë

Konsumi i energjisë për vitin 2010 është bazuar në hulumtimin me anketa në të gjithë sektorët e ekonomisë për vitin 2008 të realizuar në vitin 2009 nga Instituti Riinvest. Kurse, të dhënat e konsumit për biomasën janë marrë nga rezultatet e anketës për konsumin e biomasës në sektorët e amvisërisë, shërbimeve dhe industrisë për periudhën 2009/2010 dhe 2010/2011, projekt i kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe i realizuar nga CRES-i në vitin 2011.

Gjithashtu, anketat e vitit 2009 për produktet tjera të energjisë janë korigjuar mbi bazën e të dhënave preliminare të regjistrimit të popullsisë REKOS 2011. Vlen të theksohet ndryshimi i qasjes lidhur me kodet doganore sipas rekomandimeve nga konsulenca profesionale e kontraktuar nga projekti: Mbështetje e Mëtejme e MEM, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, për çështje të të dhënave të energjisë. Në vitin 2010 ka pasur edhe zhvillime dinamike sa i përket harmonizimit të qasjes lidhur me statistikat e energjisë të të gjitha vendeve, palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë gjë që kanë ndikuar në cilësinë e dokumentit.

Prandaj, edhe në vitin 2010 kemi një shpërndarje të burimeve të energjisë konform anketave, si dhe analizave. Në vijim analizohet trendi i konsumit të energjisë sipas viteve respektivisht sektorëve të ekonomisë.

Tabela 4. Pasqyra e pjesëmarrjes së gjithë sektorëve në konsumin final (ktoe)

Sektori ekonomik	2008	2009	2010
Sektori i industrisë	232.97	237.12	254.89
Sektori i amvisërisë	461.63	456.22	461.67
Sektori i shërbimeve	111.97	111.86	113.39
Sektori i bujqësisë	18.06	18.47	18.44
Sektori i transportit	325.55	341.36	318.91
Totali	1150.18	1165.03	1167.31

Nga tab. 4 shihet se konsumi i energjisë për vitin 2010 ka qenë 1167.31 ktoe, ose një rritje prej 0.20 % krahasuar me vitin 2009. Sektori me konsumin më të madh të energjisë për vitin 2010 është amvisëria me një konsum prej 461.67 ktoe ose 40% të konsumit total, e pasuar nga sektori i transportit me një konsum prej 318.91 ktoe ose 27%, sektori industrisë me një konsum prej 254.89 ktoe ose 22%, sektori shërbimeve me një konsum 113.39 ktoe ose 10% dhe sektori i bujqësisë me një konsum 18.44 ktoe ose 2 %.




Figura 5. Pjesëmarrja e sektorëve të ekonomisë në konsumin e energjisë për vitin 2010 (%)

Në vijim paraqitet konsumi i të gjitha burimeve energjetike.

Tabela 5 . Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	62.40	57.30	82.59
Produkte nafte	494.58	526.26	489.50
Biomasë	233.13	234.74	236.35
Biokarburante	0.20	0.10	0.07
Energji elektrike	350.63	337.19	352.81
Energji solare	0.31	0.56	0.61
Ngrrohje e përfituar	8.68	8.86	5.38
Totali	1150.18	1165.03	1167.31




Figura 6. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë (ktoe)




Figura 7. Pjesëmarrja në konsum e të gjitha burimeve të energjisë për vitin 2010 (%)

Nëse analizohet konsumi i të gjitha burimeve të energjisë (tabela 5) shihet së konsumi i derivateve të naftës për vitin 2010 ka qenë 489.50 ktoe ose 41.94% i konsumit total të të gjitha burimeve të energjisë, ose një ulje të konsumit prej 6.99% krahasuar me vitin 2009, i pasuar nga energjia elektrike me 352.81 ktoe me një rritje të konsumit prej 4.63% krahasuar me vitin 2009, biomasa me 236.35 ktoe ose një rritje të konsumit prej 0.69%, thëngjilli me 82.59 ktoe, ku kemi një rritje të konsumit prej 44.15% krahasuar me vitin 2009, ngrohja e përfituruar me 5.38 ktoe, ose një ulje të konsumit prej 39.25%, energjia solare me 0.61 ktoe ose një rritje prej 9.65% krahasuar me vitin 2009 dhe biokarburantet me një ulje prej 29.21% ose 0.07 ktoe.

Tabela 6. Energjia në dispozicion dhe konsumi për vitin 2010 (ktoe)

	Thëngjill	Produkte nafte	Biomasa	Energji elektrike	Bio-karburante	Energji solare	Ngrohje e përfituruar
Energjia në Dispozicion	82.97	453.78	236.35	352.81	0.07	0.61	5.38
Konsumi	82.96	489.50	236.35	352.81	0.07	0.61	5.38
Diferenca	0.01	-35.72	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00




Figura 4. Energjia në dispozicion dhe konsumi për vitin 2010 (ktOE)

Nga Fig.4 shihet së mbulimi i kërkesave të konsumit të energjisë është realizuar relativisht mirë.

1.2.1. Konsumi i thëngjillit

Konsumi i secilit nënprodukt të thëngjillit paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 7. Pasqyra e konsumit të thëngjillit (ktOE)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracit	8.10	4.44	20.81
Thëngjill bituminoz dhe tjera	13.91	10.28	7.00
Thëngjill guri për koks	0.01	0.00	0.01
Lignit/Thëngjill i murrmë	18.04	42.58	54.65
Koks dhe gjysmë koks	3.55	0.00	0.11
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00	0.01
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00	0.00
Totali	43.61	57.30	82.59




Figura 5. Pasqyra e konsumit të thëngjillit (ktOE)

Nga tabela 7, shihet së linjiti në vitin 2010 ishte thëngjilli me i konsumuar në sektorin e amvisërisë me një pjesëmarrje prej 54.65 ktoe ose 66.17% të konsumit total, pasuar nga antraciti me 20.81 ktoe, ose 25.20%, thëngjilli bituminoz dhe tjera me 7.0 ktoe, ose 8.48% dhe koksi dhe gjysmë koks me 0.11 ktoe, ose 0.13%.

1.2.2. Konsumi i produkteve të naftës

Tabela 8. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës (ktoe)

Produkte nafte	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.00	0.00
Benzinë aviacioni	0.00	0.00	0.05
Benzinë	91.66	96.25	82.55
Kerozinë	0.30	0.42	1.24
Vajra karburantesh/mazut	65.11	75.81	67.02
Naftë	287.67	301.49	288.66
GLN	49.85	52.24	50.02
Koks nafte	0.00	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00	0.00
Bitumeni	0.00	0.00	0.00
Totali	494.58	526.21	489.54




Figura 6. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës (ktoe)

Siç shihet nga tabela 8. nafta në vitin 2010 ishte nën-produkti më i konsumuar me një pjesëmarrje prej 288.66 ktoe ose 58.96% në konsumin total të derivateve të naftës, pasuar nga benzina me 82.56 ktoe, ose 16.86%, mazuti me 67.02 ktoe, ose 13.69 % dhe GLN me 50.02 ktoe ose 10.22 %.

1.2.3 Konsumi i energjisë elektrike

Në vitin 2010 konsumi i energjisë elektrike ka qenë 352.81 ktoe. Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i energjisë elektrike në të gjithë sektorët ekonomik.

Tabela 9. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike (ktoe)

Sektori	2010
Industria	99.01
Transporti	0.00
Amvisëria	192.81
Bujqësia	6.11
Shërbimet	54.87
Totali	352.81




Figura 7. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomik (%)

Siç shihet nga tab. 9 sektori i amvisërisë është konsumatori më i madh i energjisë elektrike me një konsum prej 192.81 ktoe ose 54.65% të konsumit total të energjisë elektrike, e pasuar nga sektori i industrisë me konsum prej 99.01 ktoe ose 28.06%, sektori i shërbimeve me konsum prej 54.87 ktoe ose 15.55% dhe sektori i bujqësisë me konsum prej 6.11 ktoe ose 1.73%.

1.2.4. Konsumi i ngrohjes së përfituar

Konsumi total i ngrohjes së përfituar për vitin 2010 ka qenë 5.38 ktoe. Amvisëria është konsumatori kryesor me një konsum prej 3.50 ktoe ose 65% të konsumit total të ngrohjes, pasuar nga sektori i shërbimeve me konsum prej 1.88 ktoe ose 35%. Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i ngrohjes së përfituar në të gjithë sektorët ekonomik.

Tabela 10. Pasqyra e konsumit të ngrohjes së përfituar në të gjithë sektorët ekonomik (ktoe)

Sektori	2010
Industria	0.00
Transporti	0.00
Amvisëria	3.50
Bujqësia	0.00
Shërbimet	1.88
Totali	5.38

1.3. Konsumi në sektorin e industrisë

1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë

Në vitin 2010 konsumi i energjisë në sektorin e industrisë ka qenë 254.89 ktoe me një rritje prej 7.49% krahasuar me vitin 2009. Si edhe në sektorët tjerë, të dhënat e konsumit të energjisë në përgjithësi janë bazuar në të dhënat e hulumtimit për konsumin e vitit 2008 dhe 2010, të dhënat nga faturimi i KEK-u, të dhënat nga Kosova Thëngjilli dhe analizës së rritjes ekonomike.

Tabela 11. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	35.48	32.90	54.95
Produkte nafte	88.61	98.98	90.19
Biomasa	10.48	10.61	10.74
Energji elektrike	98.40	94.63	99.01
Totali	232.97	237.12	254.89




Figura 8. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

Burimi energjetik më i konsumuari në sektorin e industrisë në 2010 është energjia elektrike me 99.01 ktoe ose 38.84% të konsumit total të sektorit të industrisë, e pasuar nga derivatet e naftës me 90.19 ktoe ose 35.38%, thëngjilli me 54.95 ktoe ose 21.56% dhe biomasa me 10.74 ktoe ose 4.21%.

1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit nënprodukt të thëngjillit në sektorin e industrisë.

Tabela 12. Pasqyra e konsumit e të gjitha nën-produkteve të thëngjillit në sektorin e industrisë (ktoe)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracit	8.10	4.44	20.81
Thëngjill bituminozë dhe tjera	13.91	10.28	7.00
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00	0.00
Lignit/Thëngjill i murrëm	11.74	18.19	27.09
Koks dhe gjysmë koks	1.77	0.00	0.06
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrëm	0.00	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00	0.00
Totali	29.03	32.90	54.96




Figura 9. Pasqyra e konsumit e të gjitha nënprodukteve të thëngjillit në sektorin e industrisë (ktoe)

Nga tabela 12 shihet pasqyra e konsumit e të gjitha nënprodukteve të thëngjillit në sektorin e industrisë. Pjesëmarrja e linjtit në vitin 2010 është me 27.09 ktoe ose 49.29% dhe antraciti me 20.81 ktoe, ose me 37.86% e që janë llojet e thëngjilleve më të konsumuara në sektorin e industrisë e pasuar nga thëngjilli bituminozë dhe të tjera me 7.0 ktoe, ose 12.74 %.

1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit nënprodukt të naftës në sektorin e industrisë.

Tabela 13. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e industrisë (ktoe)

Produktet e naftës	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.00	0.00
Benzinë aviacioni	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.71	0.75	0.64
Kerozinë	0.00	0.00	0.00
Vajra karburantesh/mazuti	52.09	60.65	53.62
Naftë	23.41	24.54	23.50
GLN	12.39	12.99	12.43
Koks nafte	0.00	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00	0.00
Totali	88.61	98.92	90.19

Nga tabela 13. shohim se në konsumin e derivateve të naftës në sektorin e industrisë në vitin 2010 prinë mazuti me 59.45%, pasuar nga nafta me 26.05% , GLN me 13.79% dhe benzina me 0.71% të konsumit total të derivateve të naftës në sektorin e industrisë.




Figura 10. Pjesëmarrja në konsum e produkteve të naftës në sektorin e industrisë (%)

Sektori i industrisë përbëhet prej shumë nën-sektorëve të ndryshëm si: Industria e hekurit dhe çelikut, metaleve jo-ferrore, industria kimike, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore, industria e nxjerrjes së xeheve, industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit, industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes, industria e letrës dhe stampimit, inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve.

1.3.4 Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë

Tabela në vijim paraqet konsumin e energjisë elektrike në sektorin e industrisë.

Tabela 14. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (ktoe)

Nënsëktorët e industrisë	2010
Industria e hekurit dhe çelikut	40.30
Industria e metaleve jo-ferrore	1.28
Industria kimike	0.22
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	4.84
Industria e nxjerrjes së xeheve	1.10
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	37.04
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.08
Industria e letrës dhe stampimit	0.15
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01
Industritë tjera	13.99
Totali	99.01




Figura 11. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (%)

Konsumi total i energjisë elektrike në sektorin e industrisë për vitin 2010 ka qenë 99.01 ktoe. Industria e hekurit dhe çelikut është nënsektori i industrisë me konsumin më të lartë të energjisë elektrike me 40.30 ktoe ose 40.70% të konsumit total të energjisë elektrike në sektorin e industrisë pasuar nga industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit me 37.04 ktoe ose 37.41%, industritë tjera me 13.99 ktoe ose 14.13%, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore me 4.84 ktoe ose 4.89%, industria e metaleve jo-ferrorë me 1.28 ktoe ose 1.29%.

1.3.5 Pjesëmarrja e nënsektorëve të industrisë në konsumin e energjisë

Tabela në vijim paraqet konsumin në total të energjisë të nënsektorëve të industrisë:

Tabela 15. Pasqyra e konsumit total të energjisë të nënsektorëve të industrisë (ktoe)

Nënsektorët e industrisë	2010
Industria e hekurit dhe çelikut	59.36
Industria e metaleve jo-ferrorë	61.75
Industria kimike	1.83
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	28.40
Industria e nxjerrjes së xeheve	2.56
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	78.88
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.16
Industria e letrës dhe stampimit	0.24
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01
Industritë tjera	21.72
Totali	254.89




Figura 12. Pasqyra e konsumit total të energjisë të nënsektorëve të industrisë në 2010 (ktoe)

Nëse analizohet konsumi i energjisë sipas nënsektorëve të industrisë për vitin 2010, prinë nënsektori i industrisë së ushqimit, pijeve dhe duhanit, i cili konsumon 78.88 ktoe ose 30.90% të totalit të energjisë së konsumuar nga sektori i industrisë, i përcjellë nga nënsektori i metaleve jo-ferrorë me 61.75 ktoe 24.20% dhe nënsektori i hekurit dhe çelikut me 59.36 ktoe ose 23.30% të konsumit total të energjisë etj.

1.4. Konsumi në sektorin e amvisërisë

1.4.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë

Energjia e cila konsumohet nga amvisëria shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ngrohjen e ujit sanitar, gatim, ndriçim dhe përdorim të pajisjeve elektrike për nevoja familjare dhe individuale.

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2010 ka qenë 461.67 ktoe ose ka pasuar një rritje prej 1.20 % krahasuar me vitin 2009.

Tabela 16. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	21.35	22.16	22.20
Produkte nafte	26.06	27.33	25.41
Biomasë	215.49	216.53	217.57
Energji elektrike	191.62	184.28	192.81
Energji solare	0.16	0.17	0.18
Ngrohje e përfitur	6.95	5.76	3.50
Totali	461.63	456.22	461.67




Figura 13. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Burimi energjetik më i konsumuar në sektorin e amvisërisë për vitin 2010 është biomasa me një konsum prej 217.57 ktoe ose 47.13% të konsumit total të energjisë se konsumuar në këtë sektor, ose me një rritje prej 0.48% krahasuar me vitin 2009, e pasuar nga energjia elektrike me 192.81 ktoe, ose me një pjesëmarrje prej 41.76% të konsumit total ose një rritje prej 4.63% krahasuar me vitin 2009, produkte nafte me 25.41 ktoe, ose 5.50% e konsumit total, ose një ulje prej 7.00% krahasuar me vitin 2009, thëngjilli me 22.20 ktoe ose me një rritje prej 0.17% krahasuar me vitin 2009, ngrohja e përfitur me 3.50 ktoe, ose 0.73% e konsumit total të energjisë, apo një ulje prej 39.25% krahasuar me vitin 2009.

Pjesëmarrja e ulët e ngrohjes së përfitur në konsumin total të energjisë së sektorit të amvisërisë ndërlihet me:

- Reduktimet kolektive të konsumatorëve të ngrohtoreve të qytetit, sidomos Termokosit si pasojë e masave ndaj konsumatorëve që nuk kanë paguar energjinë, dhe
- Mungesa e lëndës djegëse për ngrohje (mazutit).

1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë

Konsumi i secilit lloj të thëngjillit në sektorin e amvisërisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela17. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracit	0.00	0.00	0.00
Thëngjill bituminozë dhe tjera	0.00	0.00	0.00
Thëngjill guri për koks	0.01	0.00	0.01
Lignit/thëngjill i murrmë	21.34	22.16	22.18
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00	0.01
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00	0.00
Totali	21.35	22.16	22.20

Nga tabela 17. shihet se linjiti është thëngjilli më i konsumuar në sektorin e amvisërisë me 22.18 ktoe, ose 99.91% të konsumit total të thëngjillit në sektorin e amvisërisë.

1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë

Konsumi i nënprodukteve të naftës në sektorin e amvisërisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela18. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Produktet e naftës	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.00	0.00
Benzinë aviacioni	0.00	0.00	0.00
Benzinë	7.15	7.51	6.44
Kerozinë	0.00	0.00	0.00
Vajra karburantesh/mazut	0.00	0.00	0.00
Naftë	8.27	8.67	8.30
GLN	10.63	11.14	10.67
Koks nafte	0.00	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00	0.00
Totali	26.06	27.33	25.41

Nga tabela 18 shihet se GLN është nënprodukti më i konsumuar në sektorin e amvisërisë me 10.67 ktoe ose 41.98% të konsumit total, pasuar nga nafta me 8.30 ktoe ose 32.66% dhe benzina me 6.44 ktoe ose 25.35%.

1.5. Konsumi në sektorin e shërbimeve

1.5.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve

Sikurse edhe të sektori i amvisërisë edhe në sektorin e shërbimeve energjia përdoret për: ngrohjen e hapësirës, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohtë, gatim në restorante, hotele, objekte shëndetësore, ndriçimin dhe pajisjet elektrike.

Tabela 19. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	5.33	1.99	5.19
Produkte nafte	44.51	48.16	44.97
Biomasë	5.46	5.75	6.04
Energji elektrike	54.53	52.44	54.87
Energji solare	0.40	0.42	0.44
Ngrohje e përfituar	1.74	3.10	1.88
Totali	111.97	111.86	113.39

Gjatë vitit 2010 sektori i shërbimeve, sipas rezultateve nga anketa dhe të dhënat zyrtare nga Kosova Thëngjilli sh.a. ka konsumuar në total 113.39 ktoe. Sektori i shërbimeve mund të kategorizohet në dy nënsektorë kryesorë: publik dhe privat, të cilët në vete përmbajnë një numër të madh të nënsektorëve si p.sh. hotelieri dhe turizëm, shëndetësi, tregti, arsim, zanate (zejtari), konsulencë, kulturë dhe sport, shërbime publike etj.

Sa i përket ngrohjes së përfituar, sikurse në sektorin e amvisërisë, edhe në sektorin e shërbimeve furnizimi me ngrohje nuk ka qenë i mirë për shkak të reduktimeve kolektive të konsumatorëve të ngrohtoreve të qytetit dhe mungesës së lëndës djegëse për ngrohje (mazutit).




Figura 14. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve (ktoe)




Figura 15. Pjesëmarrja në konsum të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve

Në vitin 2010, burimi më i preferuar në sektorin e shërbimeve është energjia elektrike me 54.87 ktoe, ose 48.39% të konsumit total, produktet e naftës me 44.97 ktoe, ose 39.66%, biomasa me 6.04 ktoe, ose 5.33%, thëngjilli me 5.19 ktoe, ose 4.58 %, ngrohja e përfituar me 1.88 ktoe. ose 1.66% dhe energjia solare me 0.44 ktoe ose 0.38%.

1.5.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e shërbimeve

Konsumi i të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e shërbimeve paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 20. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e shërbimeve (ktoe)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracit	0.00	0.00	0.00
Thëngjill bituminozë dhe tjera	0.00	0.00	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00	0.00
Lignit/thëngjill i murrmë	3.56	1.99	5.13
Koks dhe gjysmë koks	1.77	0.00	0.06
Gaz thëngjilli, gaz uji etj	0.00	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00	0.00
Totali	5.33	1.99	5.19

Lloji i thëngjillit më të konsumuar në sektorin e shërbimeve është linjiti me 5.13 ktoe, ose 98.84%, pasuar nga koksi dhe gjysmë koksi me 0.06 ktoe ose 1.16% në konsumin total të thëngjillit në këtë sektor.

1.5.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve

Konsumi i nënprodukteve të naftës në sektorin e shërbimeve paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 21. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve (ktoe)

Produktet e naftës	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.00	0.00
Benzinë aviacioni	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.30	0.31	0.27
Kerozinë	0.00	0.00	0.00
Vajra karburantesh/mazut	13.02	15.16	13.40
Naftë	17.37	18.21	17.43
GLN	13.82	14.48	13.86
Koks nafte	0.00	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00	0.00
Totali	44.51	48.16	44.97

Nënprodukti i naftës më i konsumuar në sektorin e shërbimeve është nafta me një pjesëmarrje prej 17.43 ktoe, ose 38.76%, e pasuar nga GLN me 13.86 ktoe, ose 30.83%, mazuti 13.40 ktoe, ose 29.81% dhe benzina 0.27 ktoe, ose 0.60% të konsumit total.

1.6. Konsumi në sektorin e transportit

1.6.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit

Sektori i transportit në Kosovë zhvillohet si pasojë e rritjes së numrit të automjeteve transportuese në rrugë, kapacitetit të infrastrukturës dhe transportit rrugor, hekurudhor dhe transportit ajror.

Sektori i transportit në Kosovë karakterizohet me konsum 100% të naftës dhe produkteve të saj në të gjitha nënsektorët e këtij sektori, si në: rrugorë (urban dhe ndërrurban), hekurudhor dhe ajror.

Tabela 22. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Naftë	228.66	239.64	229.45
Benzinë	83.43	87.61	75.15
Kerozinë	0.30	0.42	1.24
GLN	12.97	13.59	13.01
Totali i produkteve të naftës	325.35	341.26	318.84
Biokarburante	0.20	0.10	0.07
Totali	325.55	341.36	318.91




Figura 16. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit (ktoe)

Në sektorin e transportit hyjnë të gjitha mjetet transportuese, pra jo vetëm ato makina që merren ekskluzivisht në sektorin e transportit (maune, autobusë, taksi etj.), por edhe ato mjete që përdoren në sektorët tjerë, p.sh. makinat e përdorura në sektorin e amvisërisë dhe shërbimeve, si dhe transporti i jashtëm (jashtë objektit ku zhvillohet veprimtaria) në sektorët e industrisë dhe bujqësisë.




Figura 17. Pjesëmarrja e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit (%)

Konsumi i sektorit të transportit për vitin 2010 ka qenë 318.91 ktoe. Nafta është derivati me i konsumuar në vitin 2010 me 229.45 ktoe, ose 71.9%, benzina me 75.15 ktoe, ose 23.6%, përcjellë nga GLN me 13.01 ktoe, ose 4.1% dhe kerozina (e përdorur ekskluzivisht në transportin ajror) me 1.24 ktoe, ose 0.40% e konsumit total.

Në Kosovë në vitin 2010, mbi 99.25% e energjisë së konsumuar në sektorin e transportit harxhohet nga transporti rrugor, derisa transporti ajror konsumon 0.39% dhe transporti hekurudhor konsumon 0.36% të konsumit total.

1.7. Konsumi në sektorin e bujqësisë

1.7.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë

Konsumi energjisë në sektorin e bujqësisë për vitin 2010 ka qenë 18.44 ktoe, ose krahasuar me vitin 2009 kemi pasur një ulje prej 0.14%. Burimi më i preferuar i energjisë në sektorin e bujqësisë janë produktet e naftës me 10.08 ktoe, ose 54.67%, përcjellë nga energjia elektrike me 6.11 ktoe, ose 33.14%, biomasa me 1.85 ktoe, ose 10.84% dhe thëngjilli me 0.25 ktoe, ose 1.35% e konsumit total të energjisë.

Tabela 23. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë (ktoe)

Burimi	2008	2009	2010
Thëngjill	0.23	0.24	0.25
Produkte nafte	10.06	10.54	10.08
Biomasë	1.70	1.85	2.00
Energji elektrike	6.07	5.84	6.11
Totali	18.06	18.47	18.44




Figura 18. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë (ktoe)

1.7.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë

Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 24. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e bujqësisë (ktoe)

Thëngjill	2008	2009	2010
Antracit	0.00	0.00	0.00
Thëngjill bituminozë dhe tjera	0.00	0.00	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00	0.00
Lignit/thëngjill i murrmë	0.23	0.24	0.25
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj	0.00	0.00	0.00
Koks terpeninë nga katrani	0.00	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00	0.00
Totali	0.23	0.24	0.25

Linjiti është thëngjilli kryesor dhe i vetëm i konsumuar në sektorin e bujqësisë.

1.7.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë

Konsumi i nënprodukteve të naftës në sektorin e bujqësisë paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 25. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë (ktoe)

Produktet e naftës	2008	2009	2010
Karburantet e bardha	0.00	0.00	0.00
Benzinë aviacioni	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.07	0.07	0.06
Kerozinë	0.00	0.00	0.00
Vajra karburantesh/mazut	0.00	0.00	0.00
Naftë	9.95	10.43	9.99
GLN	0.04	0.04	0.04
Koks nafte	0.00	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00	0.00
Totali	10.06	10.54	10.08

Nafta është nënprodukti më i konsumuar në sektorin e bujqësisë me një konsum prej 9.99 ktoe ose 99.03%, pasuar nga benzina me 0.60% dhe GLN me 0.37%.

1.8. Mbulimi i kërkesës me energji

1.8.1. Furnizimi me thëngjill (lignit)

Tabela 26. Mbulimi i kërkesës me lignit sipas sektorëve ekonomik për vitin 2010 (ktoe)

Sektorët ekonomik	2010
Industria	27.09
Amvisëria	22.18
Bujqësia	0.25
Shërbimet	5.13
Konsumi final i energjisë	54.65
Në dispozicion për konsum final	54.65
Diferenca statistikore	0.00

Bazë për llogaritjen e konsumit të thëngjillit për vitin 2010 janë marrë të dhënat zyrtare nga shitja e thëngjillit (terur dhe njomë) nga Kosova Thëngjilli sh.a.

1.8.2. Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike në vitin 2010, vjen kryesisht nga prodhimi prej termocentraleve 'Kosova A' dhe 'Kosova B', hidrocentralet (Ujmani, Lumbardhi, Radavci dhe Dikanci). Sasia e energjisë elektrike e prodhuar në termocentrale gjatë vitit 2010 ishte 430.90 ktoe, ndërsa energjia elektrike e prodhuar në hidrocentrale për vitin 2010 ishte 13.38 ktoe. Po ashtu, në vitin 2010 ka pasur prodhim të energjisë elektrike nga era në sasi prej 0.04 ktoe.

Si pasojë e reduktimeve dhe aplikimit të planit ABC, sipas të dhënave të KOSTT-it energjia elektrike e pafurnizuar për vitin 2010 ka qenë 194.28 GWh. Pra, realisht, kërkesa për energji elektrike në Kosovë është më e mëdha sesa prodhohet dhe importohet.

Në tabelën vijuese paraqitet furnizimi me energji elektrike:

Tabela 27. Mbulimi i kërkesës me energji elektrike (e planifikuar dhe realizuar) për vitin 2010

Burimi	Planifikimi MWh	Realizimi MWh	Përqindja e realizimit (%)
TC Kosova A	1 410 360	1 739 815	123.36
TC Kosova B	3 238 194	3 270 605	101.00
HC Ujmani	66 000	113 861	167.44
Total Prodhimi	4 716 554	5 124 281	108.64
Eksporti	-	352 471	-
Importi	813 940	818 387	100.55
Energjia në disponim	5 530 494	5 594 203	101.21
Distribucioni	4 312 690	4 432 327	102.77
Ferronikeli	629 112	621 073	98.72
Trepça	29 000	21 217	73.16
Sharri	61 000	59 757	97.96
Konsumi brenda sektorit elektroenergjetik	145 580	328 785	225.85
Kërkesa neto	5 177 382	5 463 159	105.52
Humbjet në bartje	197 267	131 044	66.43
Kërkesa gjithsej	5 374 649	5 594 203	104.08
Ngarkesa maksimale MW	1020	1156	113.33

Burimi i informacionit: Balanca e realizuar vjetore e energjisë elektrike 2010 nga KOSTT sh.a.

Tabela 28. Prodhimi i energjisë elektrike nga HC-të distributive dhe era për vitin 2010

Burimi	MWh
HC Lumbardhi	36,083
HC Radavci	883
HC Dikanci	4,764
Totali i HC-ve distributive	41,730
Gjeneratorët me erë (BRE),Golesh	445
Totali	42,175

Burimi i informacionit: Balanca e realizuar vjetore e energjisë elektrike 2010 nga KOSTT sh.a.

Siç shihet nga tab. 27, furnizimi me energji elektrike në vitin 2010 nga prodhimi prej termocentraleve dhe HC Ujmani është realizuar në sasi prej 5124.28 GWh, kurse sasia e energjisë elektrike e furnizuar nga importi është 818.38 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike nga HC distributive për vitin 2010 ka qenë 41.73 GWh, ndërsa nga era 0.445 GWh.

1.8.3. Furnizimi me produkte të naftës

Furnizimi me produkte nafte është bërë vetëm nga importi. Pra, varshmëria nga importi është 100%.

Tab. 29. Mbulimi i kërkesës me produkte të naftës sipas sektorëve të ekonomisë për vitin 2010 (ktoe)

Spektori ekonomik	2010
Industria	90.19
Transporti	318.84
Amvisëria	25.41
Bujqësia	10.08
Shërbimet	44.97
Konsumi final i energjisë	489.50
Në dispozicion për konsum final	453.78
Diferenca statistikore	-35.72

Nga tab. 29, shihet se diferenca statistikore prej -35.72 ktoe që rezulton me mosregjistrimin e një sasive të produkteve të naftës në Doganat e Kosovës, që do të thotë se relativisht mirë janë plotësuar dhe mbuluar të gjitha kërkesat e sektorëve ekonomikë. Siç edhe është pritur, konsumatori kryesor i produkteve të naftës mbetet sektori i transportit me 318.84 ktoe, ose 65.14%, përcjellë nga sektori i industrisë me 90.19 ktoe, ose 18.42%, shërbimeve me 44.97 ktoe, ose 9.19%, amvisërisë me 25.41 ktoe ose 5.19% dhe bujqësisë me 10.08 ktoe, ose 2.06% e konsumit total.




Figura 19. Pjesëmarrja dhe mbulimi i kërkesës me produkte të naftës sipas sektorëve të ekonomisë për vitin 2010 (%)

1.9. Treguesit e konsumit të energjisë

Ekzistojnë disa tregues specifikë të cilët ndikojnë në konsumin e energjisë. Më kryesorët janë:

- konsumi i energjisë për kokë banori dhe
- intensiteti i energjisë.

Konsumi i energjisë për kokë banori - është një indikator i zhvillimit ekonomik të një vendi. Nëse analizojmë konsumin e energjisë për kokë banori, gjatë vitit 2010 është konsumuar 0.65 toe/kokë banori¹.

Intensiteti i energjisë - po ashtu, është një tregues i zhvillimit ekonomik i cili paraqet raportin ndërmjet burimeve primare të energjisë dhe Bruto Produktit Vendor (BPV). Për vitin 2010 intensiteti i energjisë ka rezultuar në 0.57 toe/1000 €.

Kosova duhet të mundohet që ta ulë intensitetin e energjisë. Edhe pse matematikisht, me rritjen e BPV-së duhet të zvogëlohet intensiteti i energjisë, kjo në realitet nuk është e domosdoshme të jetë ashtu. Mund të ndodhë që me rritjen e BPV-së të rritet edhe kërkesa për energji dhe e kundërta, por jo në mënyrë dhe me shkallë të njëjtë të rritjes.

1.10. Ndotja e mjedisit

Ndikimi i naftës dhe produkteve të saj në ndotjen e mjedisit.

Sipas disa studimeve, për çdo litër derivat të djegur mesatarisht do të lirohen: 100 g CO, 20 g VOC, 30 g NO_x dhe 2.5 kg CO₂ së bashku me disa sasi të vogla të materieve të ndryshme sikurse oksidi i sulfurit, hekuri dhe grimcave tjera të imta².

Tabela 30. Ndotësit e ambientit nga derivatet e naftës dhe automjetet

¹ Të dhënat zyrtare për numrin e banorëve të Kosovës janë marrë nga ESK-ja

² Air pollution by Jeremy Colls, faqe 127

Emisioni	Për një litër karburante (g)	Për një automjet në vit (kg)	Gjithsej (kton)
CO (Monoksid i Karbonit)	100	100	31.15
VOC (Përbërje organike lehtë e avullueshme)	20	20	6.23
NO _x (Oksidet e Azotit – NO dhe NO ₂)	30	30	9.34
CO ₂ (Dioksidi i Karbonit)	2500	2500	778.66

Burimi: Dokumenti i MZHE-së i balancës së energjisë dhe Air pollution by Jeremy Colls

Ndikimi në mjedis nga termocentralet 'Kosova A' dhe 'Kosova B'

Sasitë e emisioneve të liruara nga Termocentralet e Kosovës gjatë vitit 2010 janë si vijon³:

Tabela 31. Ndotësit e ambientit nga termocentralet

Emisioni	Njësia	TC A	TC B	Gjithsej
Pluhur	kton	10.68	6.65	17.32
SO ₂ (Dioksidi i Sulfurit)	kton	6.75	11.81	18.56
NO _x (Oksidet e Azotit – NO dhe NO ₂)	kton	7.54	13.21	20.76
CO ₂ (Dioksidi i Karbonit)	kton	2848.09	4249.30	7097.39

Burimi: Raporti i Mjedisit, KEK sh.a. për vitin 2010

Sa i përket të dhënave për emetimin e CO sipas matjeve të KEK-ut, emisioni mesatar sillet rreth 70 – 250 mg/m³N për 6% O₂, ndërsa për materiet e avullueshme nuk ekzistojnë matje.

Sipas memorandumit të Athinës për themelimin e Unionit Energjetik, të nënshkruar edhe nga Kosova (22 mars 2005), kërkesat e Direktivës 2001/80/EC duhet të përmbushen deri më 31 dhjetor 2017. Emisionet aktuale të ndotësve në termocentralet të KEK sh.a. dhe limitet sipas direktivës së sipërcekur janë:

Tabela 32. Limitet e ndotjes sipas memorandumit të Athinës

Emisioni	TC A	TC B	Limiti	Afati i arritjes
Pluhur (mg/Nm ³)	902.32	156.35	50.00	31.12.2017
SO ₂ (mg/Nm ³)	251.42	208.55	400.00	31.12.2017
NO _x (mg/Nm ³)	705.75	835.08	500.00	31.12.2017

Duhet pasur parasysh se ndotja e ambientit do të rritet dukshëm pas ndërtimit të hidrocentraleve. Mirëpo, kjo ndotje (e pritur dhe e pashmangshme) do të zvogëlohet dukshëm pas periudhës 3 vjeçare të funksionimit të hidrocentraleve.

Sasia e ujit të patrajtuar që shkarkohet në Lumin e Sitnicës nga termocentralet vlerësohet të jetë rreth 14.2 milionë m³/vit. Ndërsa, sipas CarlBro: 2003, është vlerësuar se nga minierat shkarkohen rreth 0.9 milion m³/vit në lumin e Drenicës dhe Sitnicës.

Nëse bashkojmë ndotjen e ambientit nga automjetet dhe nga termocentralet, atëherë sasia e ndotjes së ambientit do të ishte si në tabelën në vijim.

³ Të dhënat bazë për sasinë e emisioneve të liruara nga termocentralet e Kosovës janë marrë nga KEK sh.a.

Tabela 33. Ndotësit e ambientit (emisionet) nga derivatet e naftës dhe termocentralet (kton)

Emisioni	Termocentralet	Automjetet	Gjithsej
CO (Monoksid i Karbonit)	-	31.15	31.15
VOC (Përbërje Organike lehtë e avullueshme)	-	6.23	6.23
NO _x (Oksidet e Azotit – NO dhe NO ₂)	20.76	9.34	30.10
CO ₂ (Dioksidi i Karbonit)	7,097.39	778.66	7876.05
SO ₂ (Dioksidi i Sulfurit)	18.56	0	18.56
Pluhur	17.32	0	17.32

2. Konkluzionet dhe Rekomandimet

2.1. Konkluzionet

Kërkesa për energji elektrike vazhdon të rritet edhe në vitin 2010. Plotësimi i saj është realizuar nga prodhimi vendor prej TC-ve dhe HC-ve, si dhe nga importi. Mirëpo, një pjesë e nevojave ka vazhduar të gjelet e paplotësuar.

Regjistrimi i popullsisë ka nxjerrë në pah se numri i familjeve është më i ultë sesa në vlerësimet e mëhershme dhe kjo ka nxitur nevojën e rishikimeve të konsumit të viteve paraprake nga sektori i konsumit të amvisërive.

Anketimi i konsumit të biomasës për qëllime të energjisë në Komunitetin e Energjisë zhvilluar nga Qendra për BRE dhe ruajtje të energjisë (CRES) e kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka shtuar vlerë dokumentit të Balancës së Realizuar të Energjisë. Ky studim ka një vlerë edhe për sa i përket vendimmarrjes së përcaktimit të caqeve të BRE-ve, që është në proces e sipër sipas kërkesave të Komunitetit të Energjisë.

Konsumi i produkteve të naftës ka pësuar një rënie për shkak të çmimeve të energjisë të këtij produkti, si dhe për shkak të përmirësimit të ndjeshëm të furnizimit me energji elektrike dhe është reduktuar kërkesa për lëndë djegëse për gjeneratorët individualë elektrikë.

Edhe në vitin 2010, sikurse edhe në vitet e kaluara, ndotësit më të mëdhenj të mjedisit janë termocentralet 'Kosova A' dhe 'Kosova B'.

Rritja e përdorimit të thëngjillit në sektorin e amvisërisë është një dukuri e pritshme si pasojë e çmimeve më të larta të produkteve tjera alternative për ngrohje. Megjithatë, përdorimi i thëngjillit nuk është i përshtatshëm për mjedisin, kushtet ekonomike diktojnë përdorimin e tij.

2.2. Rekomandimet

Përsheptimi i procesit të ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese: Fakti i mungesës së energjisë elektrike edhe gjatë vitit 2010, si dhe afrimit të datës së dekomisionimit të TC 'Kosova A' (viti 2017), ngrenë shqetësimin për rritjen e pasigurisë së furnizimit me energji elektrike. Kjo, sa i përket TC-ve, kurse sa i përket HC-ve, është e domosdoshme që të eliminohen të gjitha barrierat e panevojshme që ndikojnë në zvarritjen e procesit të autorizimit të ndërtimit të tyre. Duhet rivlerësuar politikat mbështetëse për energjinë e erës, përderisa procesi i zhvillimit të tyre është shumë i ngadalshëm. Përderisa ka një interesim shumë të madh për zhvillimin e bizneseve të energjisë solare, është e nevojshme që të nisët procesi për futjen e këtij burimi në skemat mbështetëse, proces ky që nis me vendosjen e caqeve të energjisë solare.

Fokusim i gjithanshëm në zvogëlimin e humbjeve komerciale: Eliminimi i dukurisë së abuzimit me energji elektrike është në të njëjtën kohë edhe zvogëlim i kërkesave për energji elektrike në masë të dukshme. Ky veprim rezulton në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, përkatësisht eliminimin e reduktimeve të energjisë elektrike dhe në masë të madhe të importit të energjisë.

Diversifikim i përdorimit të burimeve të energjisë: Në shumë raste ka mundësi që përdorimi i energjisë elektrike të zëvendësohet nga GLN-ja dhe kjo duhet stimuluar. Me këtë shkarkohet rrjeti dhe rritet siguria e furnizimit me energji elektrike.

Nxitja e teknologjive për thëngjill të pastër: Përdorimi gjithnjë e më i madh i thëngjillit për ngrohje individuale, parashtron nevojën që të ndërmerren aktivitete që të nxiten teknologjitë e përpunimit të tij, si në aspektin e rritjes së vlerës kalorike dhe largimit të ndotësve mjedisorë. Kjo do të kishte disa anë pozitive si, zvogëlimin e ndotjeve mjedisore, zhvillimin e bizneseve, rritjen e numrit të të punësuarve dhe nxitjen e përdorimit më të madh të ngrohjeve individuale qendrore etj.

Nxitja e përdorimit të paneleve solare: Konsumi i energjisë elektrike për ngrohjen e ujit sanitar në amvisëri është mjaft i lartë. Kushtet klimatike në Kosovë janë shumë të përshtatshme për zëvendësimin e energjisë elektrike për ngrohje të ujit me energji solare. Lirimi nga taksat të paneleve solare do të ndikonte në zvogëlimin e kostos së tyre dhe njëherësh rritjen e përdorimit të tyre. Me këtë do të arrihej që të ulej nevoja për energji elektrike dhe të rritej siguria e furnizimit me këtë energji elektrike, si dhe do të ulej importi i kësaj energjie, gjë që do të ktheheshin mjetet e munguara nga taksat e hequra.

Zvogëlimi i humbjeve teknike: Humbjet teknike si në sektorin e energjisë elektrike, ashtu edhe në atë të ngrohjes vazhdojnë të jenë shumë të larta. Identifikimi dhe zbatimi i masave adekuate për zvogëlimin e tyre në nivele të pranueshme është një domosdoshmëri. Në proporcion me zvogëlimin e tyre do të rritet edhe siguria e furnizimit.

Përmirësimi i efijencës së energjisë: Anketat e realizuara gjatë vitit 2009 kanë treguar se potenciali kursyes i energjisë së të gjitha llojeve është mjaft i lartë. Identifikimi i politikave dhe masave për rritjen e efijencës së energjisë janë imediate. Në proporcion të drejtë me rritjen e efijencës së energjisë është rritja e sigurisë së furnizimit me energji. Politikat e drejtuara në drejtim të zvogëlimit të çmimit të produkteve për realizimin e masave të efijencës së energjisë, do të nxisin përmirësimin e efijencës së energjisë.

S H T O J C A T

Shtojca 1. Karakteristikat e sistemit energjetik të Kosovës**Fuqitë instaluese të njësive gjeneruese nga TC-të e Kosovës**

TC	Agregati	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e instaluar MW	Fuqia në dispozicion		Minimumi teknik MW	
				Gjenerator	Prag	Gjenerator	Prag
Kosova A	A1	1962	65	0	0	0	0
	A2	1965	125	0	0	0	0
	A3	1970	200	135	110	110	100
	A4	1971	200	135	110	110	100
	A5	1975	210	135	110	100	97
Gjithsej Kosova A			800	405	330	320	297
Kosova B	B1	1983	339	290	265	200	182
	B2	1984	339	280	265	200	182
Gjithsej Kosova B			678	570	530	400	364
Kosova Thëngjill Sh.a.	N1	1970	25				
	N2	1970	16				
Gjithsej Kosova Thëngjill			41	0	0	0	0

Fuqitë instaluese të njësive gjeneruese nga HC-të e Kosovës

HC	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e dukshme MVA	Fuqia aktive në MW	Nr. i rrotull. n/min	Kuota minimale e ujit
HC Ujmani	G1	1981	19.5	17.5	428	638
	G2	1981	19.5	17.5	428	
Gjithsej Ujmani			39	35		
HC Lumbardhi	G1	1957/2005	5.05	4.04	500/915	cosφ=0.8
	G2	1957/2005	5.05	4.04	500/915	cosφ=0.8
Gjithsej Lumbardhi			10.1	8.08		
Radavci	G1	1934/ Rindërtimi 2010	0.5	0.45	1000	cosφ=0.9
	G2	1934/ Rindërtimi 2010	0.5	0.45	1000	cosφ=0.9
Gjithsej Radavci			1.0	0.90		
Istogu	G1	1948/ Rindërtimi 2011	0.475	0.427	1000	cosφ=0.9
	G2	1948/ Rindërtimi 2011	0.475	0.427	1000	cosφ=0.9
Gjithsej Istogu			0.95	0.854		
Dikanci	G1	1957/ Riparim faza I - 2010	0.55	0.5	1000	cosφ=0.8
	G2	1957/ Riparim faza I - 2010	0.55	0.5	1000	cosφ=0.8
Gjithsej Dikanci			1.1	1.0		
Gjithsej HC			52.15	45.83		

Fuqitë instaluese të njësive gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE-të)

Burimet e ripërtëritshme	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e aktive (MW)
Gjeneratorët me erë (BRE)	G1	2010	0.45
	G2	2010	0.45
	G2	2010	0.45
Gjithsej			1.35

Gjatësia e linjave në sistemin elektroenergjetik të Kosovës

LINJAT			
Tensioni i Lartë	Gjatësia	Tensioni i mesëm dhe ulët	Gjatësia
kV	km	kV	km
400	181.360	35	806
220	231.882	10	5861
110	643.490	0.4	16760
Gjithsej	1186.68		23427

Kapacitetet gjeneruese në Ngrohtoret e Kosovës

Termokos - Prishtinë		Ngrohtorja - Gjakovë		Termomit - Mitrovicë	
Kapaciteti i instaluar		Kapaciteti i instaluar		Kapaciteti i instaluar	
2X58 MW	116 MW	1X18.6 MW	18.6 MW	1X8.3 MW	8.3 MW
1X29 MW	29 MW	1X20 MW	20 MW		
2X7.5 MW	15 MW				
1X4 MW	4 MW				
2X0.8 MW	1.6 MW				
Gjithsej	165.6 MW		38.6 MW		8.3 MW

Shtojca 2. Karakteristikat e burimeve energjetike dhe konvertimi i njësive

Konvertimi i njësive

	kcal	kJ	kWh	kgoe
1 kcal	1	4.1871	0.001163	0.0001
1kJ	0.2388	1	0.000278	0.0239 x 10 ⁻³
1kWh	860	3600	1	0.086
1kgoe	10000	41871.4	11.62	1

Karakteristikat e burimeve energjetike

Lloji i energjisë	Njësitë	kJ	kgoe	toe	ktoe
Antracit	kg	31,587.50	0.754	7.54E-04	7.54E-07
Thëngjill bituminoz dhe tjera	kg	20,125.00	0.481	4.81E-04	4.81E-07
Thëngjill guri për koks	kg	29,310.00	0.700	7.00E-04	7.00E-07
Lignit	kg	7,802.15	0.186	1.86E-04	1.86E-07
Koks dhe gjysmë koks	kg	28,500.00	0.681	6.81E-04	6.81E-07
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	kg	20,000.00	0.478	4.78E-04	4.78E-07
Koks tërpentine nga katrani dhe katrani	kg	37,700.00	0.900	9.00E-04	9.00E-07
Thëngjill i murrmë	kg	8,060.24	0.193	1.93E-04	1.93E-07
Brikete të thëngjillit të murrmë	kg	20,014.53	0.478	4.78E-04	4.78E-07
Torfë	kg	10,802.82	0.258	2.58E-04	2.58E-07
Karburante të bardha	kg	43,600.00	1.041	1.04E-03	1.04E-06
Benzinë aviacioni	kg	44,006.84	1.051	1.05E-03	1.05E-06
Benzinë	kg	44,006.84	1.051	1.05E-03	1.05E-06
Kerozinë	kg	43,001.93	1.027	1.03E-03	1.03E-06
Vajra karburantesh/mazut	kg	39,610.34	0.946	9.46E-04	9.46E-07
Naftë	kg	42,290.11	1.010	1.01E-03	1.01E-06
GLN	kg	46,016.67	1.099	1.10E-03	1.10E-06
Koks nafte	kg	31,403.55	0.750	7.50E-04	7.50E-07
Produkte tjera nafte	kg	39,987.19	0.955	9.55E-04	9.55E-07
Bitumen	kg	37,684.26	0.900	9.00E-04	9.00E-07
Mbetje nafte	kg	39,987.19	0.955	9.55E-04	9.55E-07
Biomasë (20 % - lagështi)	m ³	6,155,095.80	147.17	1.47E-01	1.47E-04
Biomasë (40 % - lagështi)	m ³	3,596,585.77	85.90	8.59E-02	8.59E-05
Biomasë (45 % - lagështi)	m ³	3,507,670.18	83.77	8.38E-02	8.38E-05
Biokarburante	kg	6,168,000.00	0.874	8.74E-04	8.74E-07
Ngrohje e përfitur	kWh	3,600.94	0.086	8.60E-05	8.60E-08
Energji elektrike	kWh	3,600.94	0.086	8.60E-05	8.60E-08

Shtojca 3. Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për 2010 (ktoe)	Totali	Antracit	Thëngjill bituminoz dhe tjera	Thëngjill guri për koks	Lignit/thëngjill i murrëm	Koks dhe gjysëm koks	Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	Koks terpeninë nga katrani	Brikete të thëngjillit të murrëm	Katran	Torfë	Totali i thëngjillit
Prodhimi primar	1860.77				1611.63							1611.63
Prodhimet e përfituara												
Importet	574.77	20.81	7.54	0.01	7.44	0.11	0.00	0.00	0.01	0.00	0.37	36.31
Diferenca e stokut	36.94				36.94							36.94
Eksportet	34.97	0.00	0.55	0.00	3.47	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4.01
Bunkerët												
Konsumi i brendshëm bruto	2437.51	20.81	7.00	0.01	1652.54	0.11	0.00	0.00	0.01	0.00	0.37	1680.86
Hyrja në transformim	1610.86	0.00	0.00	0.00	1597.89	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1597.89
Termocentralet	1603.17				1597.89							1597.89
Termocentralet me prodhim automatik												
Centralet bërthamore												
Implantet me lëndë djegëse të patentuara dhe brikete												
Implantet me furrë koksi												
Implantet me furrë martin												
Stacionet e gazifikimit												
Rafineritë												
Implantet e ngrohjes qëndrore												
Panele solare												
Daljet nga Transformimi	438.66	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Termocentralet	430.90											
Termocentralet me prodhim automatik												
Centralet bërthamore												
Implantet me lëndë djegëse të patentuara dhe brikete												
Implantet me furrë koksi												
Implantet me furrë martin												
Stacionet e gazifikimit												
Rafineritë												
Implantet e ngrohjes qëndrore	7.15											
Panele solare	0.61											
Shkëmbimet dhe transferet, kthimet	0.00											
Transferet e mesproduktit	0.00											
Produktet e transferuara												
Kthimet nga industria petrokimike												
Humbjet në transformim	1170.29				1166.99							1166.99
Konsumi nga degët e energjisë (vetëkonsumi)	52.38											
Humbjet në bartje dhe shpërndarje	80.96											
Në dispozicion për konsum final	1131.97	20.81	7.00	0.01	54.65	0.11	0.00	0.00	0.01	0.00	0.37	82.97
Konsumi final jo-energjetik	0.37									0.00	0.37	0.37
Industria kimike	0.37									0.00	0.37	0.37
Sektorët tjerë	0.00									0.00	0.00	0.00
Konsumi final i energjisë	1167.31	20.81	7.00	0.01	54.65	0.11	0.00	0.00	0.01	0.00	0.00	82.59
Industria	254.89	20.81	7.00		27.09	0.06						54.95
Industria e hekurit dhe çelikut	59.36	10.40	7.00		1.10	0.03						18.53
Industria e metaleve jo-ferrere	61.75	6.24			0.00	0.02						6.27
Industria kimike	1.83				0.00							0.00
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	28.40				0.01							0.01
Industria e nxjerrjes së xeheve	2.56				0.00							0.00
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	78.88	4.16			25.91							30.07
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshëmbathjes	0.16				0.00							0.00
Industria e letrës dhe stampimit	0.24				0.01							0.01
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01				0.00							0.00
Industritë tjera	21.72				0.06							0.06
Transporti	318.91											
Transporti hekurudhor	1.15											
Transporti rrugor	316.52											
Transporti ajror	1.24											
Navigacioni i brendshëm												
Amvisëria	461.67			0.01	22.18				0.01			22.20
Bujqësia	18.44				0.25							0.25
Shërbimet	113.39				5.13	0.06						5.19
Diferenca statistikore	-35.71	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për 2010 (ktoe)	Karburantet e bardha	Benzinë aviacioni	Benzinë	Kerozinë	Vajra karburantesh/mazut	Naftë	GLN	Koks naftë	Produkte tjera naftë	Mbetje naftë	Bitumen	Totali i produkteve të naftës
Prodhimi primar												
Prodhimet e përfituara												
Importet	0.01	0.05	82.56	1.24	77.56	247.04	27.53	29.33	1.29	0.00	0.17	466.77
Diferenca e stokut												
Eksportet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.09	0.00	0.00	0.00	0.04	0.00	0.52	0.64
Bunkerët												
Konsumi i brendshëm bruto	0.01	0.05	82.56	1.24	77.47	247.04	27.53	29.33	1.25	0.00	-0.35	466.13
Hyrja në transformim					10.45	1.91						12.35
Termocentralet					3.37	1.91						5.28
Termocentralet me prodhim automatik												
Centralet bërthamore												
Implantet me lëndë djegëse të patentuara dhe briqete												
Implantet me furrë koksi												
Implantet me furrë martin												
Stacionet e gazifikimit												
Rafineritë												
Implantet e ngrohjes qëndrore					7.08							7.08
Panele solare												
Daljet nga Transformimi	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Termocentralet												
Termocentralet me prodhim automatik												
Centralet bërthamore												
Implantet me lëndë djegëse të patentuara dhe briqete												
Implantet me furrë koksi												
Implantet me furrë martin												
Stacionet e gazifikimit												
Rafineritë												
Implantet e ngrohjes qëndrore												
Panele solare												
Shkëmbimet dhe transferet, kthimet												
Transferet e mesproduktit												
Produktet e transferuara												
Kthimet nga industria petrokimike												
Humbjet në transformim					3.29							3.29
Konsumi nga degët e energjisë (vetëkonsumi)												
Humbjet në bartje dhe shpërndarje												
Në dispozicion për konsum final	0.01	0.05	82.56	1.24	67.02	245.13	27.53	29.33	1.25	0.00	-0.35	453.78
Konsumi final jo-energjetik	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Industria kimike											0.00	0.00
Sektorët tjerë												0.00
Konsumi final i energjisë	0.00	0.05	82.56	1.24	67.02	288.66	50.02	0.00	0.00	0.00	0.00	489.50
Industria	0.00	0.00	0.64	0.00	53.62	23.50	12.43	0.00	0.00	0.00	0.00	90.19
Industria e hekurit dhe çelikut			0.00		0.00	0.48	0.00	0.00	0.00			0.48
Industria e metaleve jo-ferrore			0.00		47.32	6.85	0.04	0.00				54.20
Industria kimike			0.03		0.00	0.04	1.51					1.58
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore			0.40		3.77	11.40	7.70					23.27
Industria e nxjerrjes së xeheve			0.01		1.05	0.35	0.00					1.41
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit			0.16		0.79	3.25	3.05					7.24
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshëmbathjes			0.00		0.07	0.01	0.00					0.07
Industria e letrës dhe stampimit			0.00		0.00	0.07	0.01					0.07
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve			0.00		0.00	0.00	0.00					0.00
Industritë tjera			0.04		0.62	1.06	0.13					1.86
Transporti	0.00	0.05	75.15	1.24		229.45	13.01	0.00	0.00	0.00	0.00	318.84
Transporti hekurudhor			0.00			1.15	0.00					1.15
Transporti rrugor			75.15			228.29	13.01					316.45
Transporti ajror		0.05	0.00	1.24		0.00	0.00					1.24
Navigacioni i brendshëm			0.00			0.00	0.00					
Amvisëria	0.00	0.00	6.44			8.30	10.67	0.00	0.00	0.00	0.00	25.41
Bujgësia	0.00	0.00	0.06			9.99	0.04	0.00	0.00	0.00	0.00	10.08
Shërbimet	0.00	0.00	0.27		13.40	17.43	13.86	0.00	0.00	0.00	0.00	44.97
Diferenca statistikore	0.01	0.00	0.00	0.00	0.00	-43.53	-22.49	29.33	1.25	0.00	-0.35	-35.72

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Balanca Vjetore (e realizuar) e Energjisë për 2010 (ktoe)	Biomasë	Biokarburante	Hidroenergji	Energji solare	Energji e erës	Ngrrohje e përfituar	Energji elektrike
Prodhimi primar	235.11		13.38	0.61	0.04		
Prodhimet e përfituara			0.00				
Importet	1.24	0.07	0.00				70.38
Diferenca e stokut			0.00				
Eksportet	0.00	0.00	0.00				30.31
Bunkerët			0.00				
Konsumi i brendshëm bruto	236.35	0.07	13.38	0.61	0.04		40.07
Hyrja në transformim	0.00	0.00	0.00	0.61	0.00		0.00
Termocentralet							
Termocentralet me prodhim automatik							
Centralet bërthamore							
Impiantet me lëndë djegëse të patentuara dhe briqete							
Impiantet me furrë koksi							
Impiantet me furrë martin							
Stacionet e gazifikimit							
Rafineritë							
Impiantet e ngrohjes qëndrore							
Panele solare				0.61			
Daljet nga Transformimi	0.00	0.00	0.00	0.61	0.00	7.15	430.90
Termocentralet							430.90
Termocentralet me prodhim automatik							
Centralet bërthamore							
Impiantet me lëndë djegëse të patentuara dhe briqete							
Impiantet me furrë koksi							
Impiantet me furrë martin							
Stacionet e gazifikimit							
Rafineritë							
Impiantet e ngrohjes qëndrore						7.15	
Panele solare				0.61			
Shkëmbimet dhe transferet, kthimet	0.00		-13.38		-0.04		13.42
Transferet e mesproduktit			-13.38		-0.04		13.42
Produktet e transferuara							
Kthimet nga industria petrokimike							
Humbjet në transformim	0.00						
Konsumi nga degët e energjisë (vetëkonsumi)	0.00					0.69	51.69
Humbjet në bartje dhe shpërndarje	0.00					1.08	79.88
Në dispozicion për konsum final	236.35	0.07	0.00	0.61	0.00	5.38	352.81
Konsumi final jo-energjetik	0.00						0.00
Industria kimike							
Sektorët tjerë							
Konsumi final i energjisë	236.35	0.07	0.00	0.61	0.00	5.38	352.81
Industria	10.74	0.00	0.00		0.00		99.01
Industria e hekurit dhe çelikut	0.05						40.30
Industria e metaleve jo-ferrorë	0.00						1.28
Industria kimike	0.03						0.22
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	0.27						4.84
Industria e nxjerrjes së xeheve	0.05						1.10
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	4.53						37.04
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshëmbathjes	0.00						0.08
Industria e letrës dhe stampimit	0.01						0.15
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.00						0.01
Industritë tjera	5.81						13.99
Transporti	0.00	0.07	0.00		0.00		
Transporti hekurudhor							
Transporti rrugor		0.07					
Transporti ajror							
Navigacioni i brendshëm							
Amvisëria	217.57	0.00	0.00	0.18	0.00	3.50	192.81
Bujqësia	2.00	0.00	0.00	0.00	0.00		6.11
Shërbimet	6.04	0.00	0.00	0.44	0.00	1.88	54.87
Diferenca statistikore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

